



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr.105/13
Prishtinë më dt.17.07.2013

DOGANAT E KOSOVËS
Zyrës së Drejtorit të përgjithshëm

PRISHTINË

Lidhur me kërkesën e juaj nr.313 te dt.02.05.2013, Zyra e Kryeprokurorit te Shtetit te Kosovës, jep këtë

MENDIM JURIDIK

Vepra penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 1 i Kodit penal të Kosovës kryhet nga kryerësi me qëllim që vetes apo personit tjetër ti mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore apo tarifave të tjera ose detyrimeve doganore me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave.

Importimin apo eksportimin e mallrave mund ta kryejnë personat fizik dhe juridik.

Vepra penale kryhet në dy mënyrë :

E para, me mundësimin e shmangies nga detyrimet, me veprime të rëndomta që nënkuptojnë mosparaqitjen e mallit apo mënyrat tjera që mund ti referohen pakujdesisë dhe që nuk tregojnë vendosmëri të madhe të kryesit, dhe

E dyta, me mundësimin e shmangies nga detyrimet doganore, me veprime qëllimore dhe me vendosmëri të intensitetit të lartë që nënkupton paraqitjen e dokumenteve të rrejshme lidhur me prejardhjen vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat e mallit si dhe me adaptimin e mjeteve transportuese apo valixheve për fshehjen e mallit.

Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore e kryer sipas mënyrës së parë e që nuk tejkalonë shumën prej 500 euro, mund të konsiderohet si kundërvajtje përkatëse doganore dhe ndaj kryerësit zbatohet procedurë për kundërvajtëse doganore.

Dogana e Kosovës do t'ia dërgoj Prokurorisë kompetente secilën kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse për të vlerësuar se a ka vend edhe për ndjekje për vepër penale.

KRYEPROKURORI I SHKUTËTIT

Ismet Kabashi

